

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1737 | Prot. 3

Vlorë më, 29.09.2023

VENDIM  
Nr. 43, datë 29.09.2023

PËR

MIRATIMIN E NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MIDIS  
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË DHE ALBANIAN AMERICAN  
DEVELOPMENT FOUNDATION (AADF)


Në mbështetje të nenit 38, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19,31 pika 10 , të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe referuar relacionit të Zvendesrektorit për Kerkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë ardhur me shkresën nr.1557 prot, datë 06.09.2023, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 29.09.2023,


VENDOSI:

1. Të miratojë nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe Albanian-American Developement Foundation (AADF).
2. Bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi materiali përkatës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK  
Prof.Dr. ROLAND ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
REKTORI

Nr. 1557 Prot.

Vlorë, më 06/09/2023

Lënda: Relacion shpjegues

PROF. DR. ROLAND ZISI  
KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

KËTU:

Në bazë të Nenit 38 të Ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Neni 19 i Statutit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Plani Strategjik i UV (Linja Strategjike Nr. 3) si dhe në kuadër të zhvillimit Institucional, po Ju përcjell një relacion shpjegues mbi mundësinë e nënshkrimit të një marrveshje bashkpunimi midis UV dhe Albanian-American Development Foundation (AADF). Kjo marrveshje ka si qëllim kryesor zbatimin e projektit "*Promovimin dhe zbatimin e Programit Research Expertise from the Academic Diaspora (READ)*". Qëllimi i kësaj marrëveshje është bashkpunimi i Palëve për zbatimin e Programit READ pranë Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Universiteti do të marrë pjesë në Programin READ si institucion pritës në përputhje me temat dhe kushtet e përgjithshme të Programit READ, të hartuara nga AADF dhe IIE. Ky projekt tashmë ka filluar të implemenohej në disa IAL-ë Shqiptare.

Përsitimet kryesore që UV do të ketë nga nënshkrimi i kësaj marrveshje janë:

1. Vënia në dijeni e studimeve të fizibilitetit të kryera nga AADF për zhvillimin e Programit READ, si dhe statistika e të dhëna me rëndësi përfkasur e këtij bashkpunimi;
2. Mbulimin e kostove përsituesve të Programit READ deri në vlerën e bursave të ofruara për akademikët nga Diaspora dhe granteve të kërkimit shkencor të ofruara për akademikët që punojnë pranë Universitetit, sipas parashikimeve të bëra në marrëveshje;
3. Mbështetja e Universitetit dhe fakultetet respektive në realizimin e eveneve, si konferenca shkencore, revista shkencore që lidhen më zhvillimin e kërkimit shkencor sipas prioriteteve të Programit READ.

Detyrimet kryesore që UV do të ketë nga nënshkrimi i kësaj marrveshje janë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
REKTORI


1. Të promovojë në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme Programin READ në përputhje me kërkesat e kësaj Marrëveshje dhe të ofrojë mbështetje institucionale për promovimin e Programit READ nëpërmjet strukturave të tij;
2. Të lehtësojë bashkëpunimin e akademikëve të Universitetit me akademikët e përzgjedhur në katër drejtimet e Programit READ;
3. Të identifikojë, si dhe angazhojë fakultetet e tij për të identifikuar, nevojat e brendshme të fakulteteve sipas prioriteteve të fakulteteve për përmirësimin e kërkimit shkencor dhe nevojat specifike për angazhimin e diasporës akademike shqiptare në përbushje të qëllimeve të tyre akademike dhe në mësimdhënënic;
4. Të bashkëpunojë me akademikët nga Diaspora përsitues të Programit READ për zhvillimin e kurrikulës, duke zgjeruar kërkimin shkencor dhe zhvilluar programe të reja ose për kryerjen e kërkimit shkencor të përbashkët bazuar në ekspertizën e tyre dhe interesin e ndërsjellë;
5. Të publikojë dhe promovojë thirrjet për Programin READ që do ndahan nga AADF.

Ju saleminderit për bashkpunimin!

ZV. REKTOR  
PROF. ASOC. ENKELEJD MËHILLI



Albanian-American  
Development Foundation



---

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

Albanian-American Development Foundation

dhe

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Për

Promovimin dhe zbatimin e Programit  
Research Expertise from the Academic Diaspora (READ)

Shtator 2023

2023 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ("Marrëveshja") midis palëve të mëposhtme:

**American Development Foundation (Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim), një organizatë nprurëse, e themeluar sipas ligjeve të Shtetit të Delaware, SH.B.A, e cila vepron nëpërmjet degës së saj shqipëri, të regjistruar me Vendim nr. 359, datë 18.03.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIP 1618452N dhe adresë të regjistruar në Rrugën "Ibrahim Rugova", Ndërtesa 42, Hyrja 7, Apartamenti 60, 1019, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Z. Aleksandër Sarapulli që Z. Martin Mata (në vijim referuar si "AADF").**

Dhe

**Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali", institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën Lagjia "Pavarësia", Rr. "Kosova" 9400 Vlorë, Shqipëri, i përfaqësuar nga Rektori, Prof. Roland Zisi (në vijim referuar si "Universiteti"),**

Referuar këtu më poshtë individualisht si "Pala" dhe bashkërisht si "Palët"

**MEQENËSE:**

- (A) AADF ka themeluar, zhvilluar dhe vendosur për të zbatuar, me fondet e veta dhe në bashkëpunim me Institute of International Education ("IIE"), programin e bursave për akademikët nga Diaspora Shqiptare të titulluar "Research Expertise from the Academic Diaspora" ("Programi READ"), për krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm midis Diasporës Shkencore dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë ("IAL") në Shqipëri, me qëllim forcimin e kapaciteteteve institucionale dhe cilësinë e kërkimit shkencor në Shqipëri. Një përshtkim i shkurtër i Programit READ i bashkëlidhet kësaj Marrëveshje si Aneksi I i saj.
- (B) AADF, në bashkëpunim me IIE, do të zbatojë dhe administrojë Programin READ për një periudhë 7-vjeçare, me vlerë totale deni në 2,75 Milion USD, duke u fokusuar kryesisht në katër drejtime: (i) kërkim shkencor i përbashkët për publikime në revista me faktor të lartë impakti; (ii) mbikëqyrje të doktoraturave në Shqipëri me mentorë nga Diaspora Shkencore; (iii) zhvillim dhe përmirësim të kurrikulës dhe hartim i programeve të përbashkëta; dhe (iv) bashkë-mësimdhënie.
- (C) Universiteti synon të mbetet model i arsimit të lartë publik i karakterizuar nga përgatitje rigoroze akademike dhe kërkim i thelluar shkencor, një institucion arsimor i zgjedhjes së parë për studentët e angazhuar për të transferuar jetën e tyre dhe shoqërinë. Universiteti e konsideron si nevojë të brendshme përmirësimin e cilësisë së kërkimit shkencor dhe kapaciteteteve të stafit akademik.
- (D) Palët, duke ndarë të njëjtin këndvështrim për rëndësinë e rritjes së cilësisë së kërkimit shkencor në Shqipëri, si dhe angazhimin e Diasporës Akademike Shqiptare në vendet e OECD-së, kryesisht SHBA dhe vendet e Evropës Perëndimore për të kontribuar në vendin e origjinës, bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje, për të përcaktuar kushtet dhe termat e bashkëpunimit të tyre, si më poshtë:

**Neni 1  
Objekti i bashkëpunimit**

- 1.1 Qëllimi i kësaj Marrëveshje është bashkëpunimi i Palëve për zbatimin e Programit READ pranë Universitetit. Universiteti do të marrë pjesë në Programin READ si institucion pritës në përputhje me termat dhe kushtet e përgjithshme të Programit READ, të hartuara nga AADF dhe IIE.
- 1.2 Kjo Marrëveshje përcakton angazhimet dhe përgjegjësitë e Palëve në kuadër të bashkëpunimit të tyre për promovimin dhe zbatimin e Programit READ, si dhe arritjen e objektivave të parashikuara në Aneksin I të kësaj Marrëveshje.

**Neni 2**  
**Të drejtat dhe detyrimet e Palëve**

Në kuadër të kësaj Marrëveshje, AADF angazhohet për sa më poshtë vijon:

- 2.1.1 të ndajë me Universitetin dhe fakultetet respektive studimet e fizibilitetit të kryera nga AADF për zhvillimin e Programit READ, si dhe statistika e të dhëna me rëndësi përfshirë fokusin e këtij bashkëpunimi;
  - 2.1.2 të ndajë me Universitetin dhe fakultetet respektive thirrjet publike të Programit READ përfshirë publikuar dhe promovuar nga Universiteti dhe rrjeti i tij;
  - 2.1.3 të mbulojë kostot e përfituesve të Programit READ deri në vlerën e bursave të ofruara përfshirë akademikët nga Diaspora dhe granteve të kërkimit shkencor të ofruara përfshirë akademikët që punojnë pranë Universitetit, sipas parashikimeve të bëra në Aneksin I të kësaj Marrëveshje;
  - 2.1.4 të ftojë Universitetin dhe fakultetet respektive në aktivitetet dhe eventet me interes përfshirë fushën e zbatimit të Programit READ, të organizuara nga AADF apo partnerët e tij;
  - 2.1.5 të monitorojë zbatimin e Programit READ nëpërmjet stafit të tij dhe rrjetit të projektit CleanScore që operon pranë fakulteteve të Universitetit;
  - 2.1.6 të bashkëpunojë dhe të mbështesë Universitetin dhe fakultetet respektive në realizimin e eveneve, si konferenca shkencore, revista shkencore që lidhen më zhvillimin e kërkimit shkencor sipas prioriteteve të Programit READ;
  - 2.1.7 të caktojë një pikë kontakti përfshirë çdo çështje që lidhet me zbatimin e kësaj Marrëveshje.
- 2.2 Në kuadër të kësaj Marrëveshje, Universiteti angazhohet për sa më poshtë vijon:
    - 2.2.1 të promovojë në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme Programin READ në përputhje me kërkesat e nenit 3 të kësaj Marrëveshje dhe të ofrojë mbështetje institucionale përfshirë promovimin e Programit READ nëpërmjet strukturave të tij;
    - 2.2.2 të lehtesojë bashkëpunimin e akademikëve të Universitetit me akademikët e përgjedhur në katër drejtimet e Programit READ të parashikuara në Aneksin I të kësaj Marrëveshje;
    - 2.2.3 të angazhohet në aktivitetet e organizuara nga AADF në kuadër të rritjes se kapaciteteve te institucionit pritës lidhur me shkrimin dhe menaxhimin e projekteve te përbashkëta, si dhe trajnime te tjera përfshirë qëllime të këtij programi;
    - 2.2.4 të identifikojë, si dhe angazhojë fakultetet e tij përfshirë identifikuar, nevojat e brendshme të fakulteteve sipas prioriteteve te fakulteteve përfshirë përmirësimin e kërkimit shkencor dhe nevojat specifike përfshirë angazhimin e diasporës akademike shqiptare në përmbytje të qëllimeve të tyre akadernike dhe në mësimdhënie;
    - 2.2.5 të identifikojë, dëshirojë fakultetet e tij përfshirë identifikuar, nevojat përfshirë kurrikulë të re dëshiruar përfshirë kërkimin shkencor në fusha akademike prioritare dhe të propozojë projekte përbashkëtë akademik ndërkombëtar;
    - 2.2.6 Të bashkëpunojë me akademikët nga Diaspora përfitues të Programit READ përfshirë zhvillimin e kurrikulës, duke zgjeruar kërkimin shkencor dhe zhvilluar programe të reja ose përfshirjen e kërkimit shkencor të përbashkët bazuar në ekspertizën e tyre dhe interesin e ndërsjellë;
    - 2.2.7 të publikojë dhe promovojë thirrjet përfshirë Programin READ që do ndahen nga AADF;
    - 2.2.8 të informojë të gjithë rrjetin e tij (fakultet, etj.) përfshirë Programin READ si dhe të ndajë me ta çdo thirrje përfshirë aplikim përfshirë grantet;
    - 2.2.9 të krijojë kushte të përshtatshme përfshirë personelin e përgjedhur nga diaspora akademike shqiptare, përfshirë ushtruar detyrën e tyre, sipas termave dhe kushteve të pjesëmarrësve dhe institucioneve pritëse, të hartuara nga AADF dhe IIE;
    - 2.2.10 të sigurojë pjesëmarrjen e akademikëve nga Diaspora, të përgjedhur nga programi READ, në bashkëmësimdhënie me pedagogët e Universitetit dhe fakulteteve respektive në lëndë/kurse specifike si dhe të kryejë të gjitha procedurat administrative të nevojshme përfshirë realizimin e këtij angazhim;
    - 2.2.11 të ndryshojë sipas nevojës kuadrin rregulator të brendshëm të funksionimit të tij, në përputhje me procedurat e brendshme të tij, përfshirë lehtesar procedurat administrative përfshirë personelin e përgjedhur nga diaspora akademike shqiptare lidhur me procesin e bashkë-mësimdhënieve;

- të propozojë kandidatë të kualifikuar dhe me integritet, duke ruajtur balancat midis njësive të tij përbërëse, për t'u përzgjedhur nga AADF dhe IIE si anëtarë në bordin këshillimor;
- 2.2.13 të caktojë personel të kualifikuar përgjegjës për zbatimin e Programit READ pranë Universitetit, dhe të sigurojë pjesëmarrjen e tij në takimet, seminaret dhe prezantimet e organizuara nga AADF;
- 2.2.14 të marrë pjesë, së bashku me akademikët nga Diaspora dhe nga vendi, në aktivitetet dhe mbledhjet e studentëve alumni për të rritur numrin e bursave në kohortat e ardhshme, kontribuar në qëndrueshmérinë e Programit READ dhe në vijimësi të identifikojë fusha potenciale për bashkëpunim;
- 2.2.15 të ftojë AADF-në në aktivitetet dhe eventet me interes përfushën e zbatimit të Programit READ, të organizuara nga Universiteti apo partnerët e tij;
- 2.2.16 universiteti nuk ka detyrime financiare në kuadër të kësaj marrveshje;
- 2.2.17 të caktojë një pikë kontakti për çështjet që lidhet me zbatimin e kësaj Marrëveshje.

#### **Neni 3 Deklarimet publike**

- 3.1 Për qëllim të kësaj Marrëveshje, "Deklaratë Publike" do të thotë çdo shpërndarje informacioni tek publiku në lidhje me Programin READ, nëpërmjet komunikatave përshtyp, çdo prodhim audiovizual dhe të shkruar në formën e intervistave, dokumentareve, emisioneve, deklaratave ose daljeve publike, përfaqësuesve, personave të autorizuar ose punonjësve të saj, në media, rrjete sociale dhe çdo formë tjeter komunikimi publik.
- 3.2 Universiteti duhet të njoftojë paraprakisht AADF-në përfundimt komunikatave përshtyp, çdo prodhim audiovizual dhe të shkruar në formën e intervistave, dokumentareve, emisioneve, deklaratave ose daljeve publike, përfaqësuesve, personave të autorizuar ose punonjësve të saj, në media, rrjete sociale dhe çdo formë tjeter komunikimi publik.
- 3.3 Universiteti do të njohe dhe përmendë në gjuhë të përshtatshme në të gjitha Deklaratat Publike Programin READ si një program i themeluar dhe implementuar nga AADF, duke njohtur publikisht AADF-në si financues të vetëm të Programit READ.

#### **Neni 4 Deklarimet dhe garancitë**

- 4.1 Në këtë datë, Palët deklarojnë dhe garantojnë sa më poshtë:
- 4.1.1 Ata kanë kompetencat dhe autoritetin e plotë përfundimt të Programit READ, më 30.06.2028. Palët mund të negociojnë zgjerimin e objektit ose zgjatjen e vlefshmërisë së kësaj Marrëveshje;
- 4.1.2 Ata kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme përfundimt të autorizimin e lidhjes së kësaj Marrëveshje dhe përfundimt përmbytjen e angazhimeve të tyre sipas kësaj Marrëveshje.

#### **Neni 5 Kohëzgjatja dhe zgjidhja**

- 5.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dy Palët dhe do të jetë e vlefshme deri në datën zyrtare të përfundimit të Programit READ, më 30.06.2028. Palët mund të negociojnë zgjerimin e objektit ose zgjatjen e vlefshmërisë së kësaj Marrëveshje. Në çdo rast, ndryshimet do të shkëmbohen në formë zyrtare me shkrim.
- 5.2 Kjo Marrëveshje mund të zgjidhet para përfundimit të afatit të mësipërm me dakordësinë e përbashkët të Palëve ose nga secila Palë nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Palës tjeter të paktën 90 (nëntëdhjetë) ditë përpëra datës së zgjidhjes. Në rast se në datën e zgjidhjes, akademikët e përzgjedhur para datës së njoftimit përfundimt përfundimt përfundimt të Programit READ pranë Universitetit, data efektive e zgjidhjes do të zgjatet deri në datën e përfundimit të Programit READ nga të gjithë këta

Bemikë. Pas marrjes së një njoftimi për zgjidhje, AADF nuk do të angazhojë akademikë të tjera përekjen e Programit READ pranë Universitetit.

AADF i lind e drejta të zgjidhë këtë Marrëveshje në mënyrë të menjëherëshme nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Universitetit dhe të kufizojë bashkëpunimin edhe në projektet e tjera aktuale dhe të ardhshme me Universitetin, nëse ky i fundit nuk përbush detyrimet e caktuara në këtë Marrëveshje (detyrimet e përcaktuara sipas pikës 2.2 të kësaj marrëveshje).

- 5.4 Pa kundërshtuar pikën 5.3 më sipër, Universiteti do t'i shpërblejë dëmin e shkaktuar AADF për veprime apo mosveprime të tij, si dhe do të mbajë AADF të mbrojtur dhe të pacenuar nga çdo pretendim apo kërkesë për shpërblim dëmi nga palë të treta të cilat shkaktohen nga veprime apo mosveprime të Universitetit në shkelje të detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshje. Zgjidhja paraprake e Marrëveshjes nuk do të cenojë të drejtën e AADF për të zbatuar të drejtat e përcaktuara në këtë pikë.

#### Neni 6 Njoftimet

Çdo njoftim ose kërkesë e kryer sipas kësaj Marrëveshje do të jetë me shkrim. Njoftimet duhet t'i dërgohen Palës tjetër me postë elektronike, dorazi ose me shërbimin postar. Secila Palë emëron formalisht personin/personat e kontaktit dhe ia komunikon Palës tjetër.

##### Për AADF:

Person Kontakti      Enrik Keco, Koordinator Projektit  
Adresa:                Rr. "Ibrahim Rugova",  
                          Ndërtesa 42, Hyrja 7, Apartamenti 60,  
                          1019 Tiranë, Shqipëri  
E-mail:                [e.kecoj@adf.org](mailto:e.kecoj@adf.org)

##### Për Universitetin:

Person Kontakti      Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli, Zv. Rektor  
Adresa:                Legjia. "Pavarësia", Rr. "Kosova" 9400 Vlorë  
E-mail:                [mechili@univlora.edu.al](mailto:mechili@univlora.edu.al)

#### Neni 7 Pronësia Intelektuale

- 7.1 Universiteti pranon se AADF dhe IIE janë mbajtës të vetëm të gjitha të drejtave të pronësisë intelektuale lidhur me Programin READ dhe se çdo produkt apo krijimtar që rezulton nga veprimitaria e AADF dhe IIE për dizajnimin, zhvillimin dhe zbatimin e Programit READ, përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale të lidhur me të, janë pronë e vetme e AADF dhe IIE, sipas marrëveshjes së lidhur midis këtyre të fundit.
- 7.2 Universiteti deklaron dhe garanton se nuk do të cenojë ose shkelë të drejtat e pronësisë intelektuale të AADF dhe/ose IIE dhe angazhohet të njoftojë AADF menjëherë në rast se vihet në dijeni të ndonjë shkelje. Përveç autorizimit me shkrim nga AADF dhe/ose IIE nëse do të jetë rasti, Universiteti nuk do të përdorë ose kopjojë materiale apo informacione në pronësi të AADF dhe/ose IIE, përfshirë sekrete tregtare, logo, mëarka tregtare, emra domain-i, software, illogari në media sociale apo çdo pronë tjetër intelektuale të këtyre të fundit.
- 7.3 Për lloje të veçanta produkte apo krijimtarish të pjesëmarrësve në Program, të drejtat e pronësisë intelektuale i përkasin pjesëmarrësit përkatës, dhe mund të rregullohen veçmas në marrëveshje të posaçme mes Pjesëmarrësit dhe Universitetit.
- 7.4 Detyrimet lidhur me moscënimin e pronësisë intelektuale sipas këtij nenit do të mbijetojnë pa kufizim kohor pas përfundimit apo zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 8 Konfidencialiteti

Secila nga Palët e kësaj Marrëveshjeje merr përsipër të mos bëjë të ditur, përhapë ose komunikojë informacione, të dhëna, dokumente në lidhje me veprimtarinë e Palës tjetër, kushtet e kësaj Marrëveshjeje, si dhe çdo informacion apo komunikime të tjera që në atë kohë nuk janë të njohura nga publiku, dhe për të cilat ajo vihet në dijeni ose merr si rezultat i nënshkrimit ose zbatimit të kësaj Marrëveshjeje ("Informacioni Konfidencial"), përveç me miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër. Gjithashtu, secila Palë merr përsipër të mos përdorë Informacionin Konfidencial për qëllime të tjera përveç qëllimit të zbatimit të angazhimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje.

- 8.2 Palët angazhohen të ruajnë të dhënat sensitive, personale dhe privatësinë e informacionit që mund të vihen në dijeni gjatë bashkëpunimit dhe zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe t'i trajtojnë këto të dhëna në përputhje me legjisacionin në fuqi.
- 8.3
- 8.4 Ky detyrim i ndërsjellë i Palëve për konfidencialitetin do të mbijetojë pa kufizim kohor pas përfundimit apo zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje.
- 8.5

## Neni 9 Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 9.1 Kjo Marrëveshje është hartuar dhe interpretohet në përputhje me legjisacionin e Republikës së Shqipërisë.

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në mirëbesim në përbushjen e kushteve dhe angazhimeve të tyre sipas kësaj Marrëveshje. Çdo pretendim ose mosmarrëveshje mes palëve lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet në mirëbesim dhe me mirëkuptim përmes diskutimeve mes palëve, nëpërmjet bisedave dhe negociatave në mirëbesim brenda një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditësh nga momenti që referohet mosmarrëveshja. Në rast se zgjidhja me pajtim dështon, atëherë mosmarrëveshja mes Palëve do të zgjidhet përmes procedurave të arbitrazhit ad hoc. Mosmarrëveshja do të gjyket nga një gjykatës i vetëm i cili emërohet nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC). Rregullat procedurale që do të zbatohen janë rregullat e arbitrazhit të UNCITRAL. Vendim i arbitrazhit do të jetë në Tiranë, Shqipëri, ndërsa gjuha e arbitrazhit do të jetë gjuha shqipe. Vendimi i gjykatësit do të jetë përfundimtar dhe ligjërisht i detyrueshëm dhe i zbatueshëm për Palët.

## Neni 10 Kufizimi i përgjegjësisë

Palët bien dakord dhe pranojnë që AADF gjëzon imunitetin dhe të drejtat e siguruara nga Marrëveshja Bilaterale Ekonomike e nënshkuar midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SH.B.A) datë 10 qershor 1992, ratifikuar me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.224 datë 11.06.1992 dhe si e tillë, AADF do të jetë imune nga çdo përgjegjësi civile dhe penale, ose çdo përgjegjësi tjetër e çdo lloji, ndaj palëve të tjera të kësaj Marrëveshje ose ndonjë pale të tretë në lidhje me këtë Marrëveshje, dhe Universiteti do të mbajë AADF të padëmtuar nga çdo kërkesë ose përgjegjësi, e çdo lloji ose natyre që mund të paraqitet ose të ndiqet zyrtarisht në lidhje me kryerjen e punës së AADF dhe/ose punonjësve të tij nën këtë Marrëveshje gjatë afatit të saj dhe/ose pas përfundimit të saj.

## Neni 11 Dispozita përfundimtare

- 11.1 Marrëvashje përbën mirëkuptimin në tërësi të Palëve dhe asnjë kusht, afat, mirëkuptim ose marrëveshje që synon të ndryshojë kushtet e kësaj Marrëveshje nuk do të jetë detyrues përvçese nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja Palët.
- 11.2 Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta mund të rregullohet me marrëveshje ose kontrata të veçanta duke bërë përpjekjet më të mira për përbushjen nga të gjitha Palët. Palët mund të bien dakord përkthimi marrëveshje shtesë në rast se mund ta gjykojnë të përshtatshme nga pikëpamja e eksperiencës, përfshirë përmirësuar ose zhvilluar një aspekt të caktuar të bashkëpunimit të tyre.
- 11.3 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dyja Palët dhe është detyruese dhe e zbatueshme përfshirë çdo pasues, pasardhës dhe përfitues të të drejtave, funksioneve dhe kompetencave përkatëse të Palëve.
- 11.4 Marrëveshja nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

#### ALBANIAN AMERICAN DEVELOPMENT FOUNDATION

---

Z. Martin Mata  
Bashkë-Drejtor Ekzekutiv

---

Z. Aleksandër Sarapulli  
Bashkë-Drejtor Ekzekutiv

Datë: \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2023

#### UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

---

Prof. Roland Zisi  
Rector

Datë: \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2023

## ANEKSI I

### PËRSHKRIM I PROGRAMIT READ

IAL synon të impaktojë në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor në Shqipëri nëpërmjet angazhimit të akademike shqiptare nga vendet e OECD-së, kryesisht SHBA dhe vendet e Evropës Perëndimore, kontribuar për periudha afat-shkurtra nga 1 deri 6 muaj në vendin e origjinës. Ky Program parashikon grantë kërkimore për të incentivuar dhe mbështetur akademikët shqiptarë dhe IAL-të në vend. Këpuni i tè dyja grupeve të interesit do të jetë kryesisht i fokusuar në këto katër drejtime:

1. kërkim shkencor i përbashkët për publikime në revista me faktor të lartë impakt;
2. mbikëqyrje të doktoraturave në Shqipëri me mentorë nga Diaspora Shkencore;
3. zhvillim e përmirësim kurrikule dhe hartimi i programeve të përbashkëta;
4. bashkë-mësimdhënie.

Diaspora akademike shqiptare është relativisht e madhe, duke marrë parasysh numrin e popullsisë dhe studime të ndryshme kanë gjetur se ajo po rritet me shpejtësi. Edhe pse akademikët shqiptarë janë të shpërndarë në të gjithë globin, grupet më të mëdha të diasporës shqiptare janë në Evropën Perëndimore dhe Amerikën e Veriut. Numri i vlerësuar i shqiptarëve nga diaspora që kanë një diplomë doktorature është 2500+, një numër i konsiderueshëm për të pasur një ndikim të madh nëse mobilizohen. Studimi i fizibilitetit i kryer nga AADF me ndihmën e konsulentëve vendas, tregon se shumica e studiuesve të diasporës (60%+) punojnë në Universitetë dhe institucionë kërkimore në vendet e tyre të banimit. Programi READ do të ofrojë një qasje të strukturuar dhe institucionale përmobilizimin e diasporës akademike shqiptare në mënyra që përfitojnë IAL-të në Shqipëri.

#### Objektivat kryesore të Programit READ janë:

- Qëndrueshmëri – Bashkëpunime të qëndrueshme midis studiuesve të diasporës dhe IAL-ve shqiptare, duke nxitur mundësinë për bashkëpunime të reja. Rritja e aksesit në financimin e kërkimit.
- Ngritisja e Kapaciteteve Institucionale – Projekte bashkëpunuese që mundësojnë përmirësimin e kërkimit shkencor, kurrikulës, programeve dhe mentorimin e doktoratës.
- Angazhimi i institucional – Përmirësimi i njohurive, rrjeteve bashkëpunuese ndërkombëtare dhe rritja e angazhimit të IAL-të shqiptare.

#### Implementimi i Programit READ në universitetet në Shqipëri

Programi READ parashikon të ofrojë 87 bursa për kërkuesit ose akademikët Shqiptarë të Diasporës i shtrire për një përiudhë 7 vjeçare, të cilët mund të kontribojnë në zhvillimin e kërkimit shkencorë sipas nevojave të IAL-ve në Shqipëri. Këta kërkues mund të angazhohen për një përiudhë 1 – 6 muaj fizikisht, virtualisht ose kombinim i të dy opsiioneve pranë një universiteti në Shqipëri. Gjithashtu, nga Program READ do të përfitojnë grante kërkimi shkencor rrëth 170 kërkues dhe/ose akademikë të cilët punojnë pranë një universiteti në Shqipëri dhe do të janë të angazhuar në një punë kërkimore përbashkët me akademikun që do të vijë nga universitetë prestigjoze të vendeve të OECD-së.